

KËRKESË
Nr. 7113/11, datë 12.4.2017

PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme, shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikualifikim i hapësirave përreth Pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja “Pasho Hysi” rruga automobilitike “Pasho Hysi” në Bashkinë e Skraparit.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia e Skraparit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 653 703 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tre) lekë.

ZËVENDESMINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME Elona Gjebrea

Bashkia e Skraparit
Lista e emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për realizimin e projektit
“Rikualifikim i hapësirave përreth pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja “Pasho Hysi” rruga automobilistike “Pasho Hysi”

Nr	Emri Mbiemri	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e ndërt./m2	Çmimi i ndërt./lek	Vlera e përgjithshme /lek	Lloji i dokumentit
1	Fatmira Tahir Xhizdari	1420	4/154	15	43 580	653 703	Vërtetim pronësie
	Totali					653 703	

